



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipality Kaçanik**

**01 Nr. 104/02-1280/23**  
**Kaçanik, 31.01.2023**

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 31 janar 2023, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL**  
**TË SIGURISË NË BASHKËSI PËR VITIN 2023**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01 Nr. 104/02-1280/23, më tekstin e mëtejme: Plani Vjetor i Punës i Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023, i hartuar nga KKSB.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësynimet në lidhje me objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSB, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2023.
3. Plani i Punës së KKSB, është përmbledhur në gjithsej 5 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: Zyra e Kryetarit të Komunës (përmes saj njoftohen anëtarët e KKSB), dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mursej